



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 1284 Prot.

Lezhë, më 27.01. 2021

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____ Datë 27.01. 2021

PËR
MIRATIMIN E ZGJEDHJEVE TË KRYETARËVE TË FSHATRAVE NË
NJËSINË ADMINISTRATIVE DAJÇ

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" nenet 8, 53, 54 dhe 70; në përputhje me Vendimin Nr. 113, datë 26.08.2020, i ndryshuar, pasi u njoh me materialin zgjedhor dhe me propozim të Kryesisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

VENDOSI :

1. Të miratojë zgjedhjen e Kryetarëve të Fshatrave në Njësinë Administrative Dajç, të cilët janë:

- | | |
|----------------------|-----------------------|
| 1.1. Fshati Dajç | Z. Gasper Gazulli |
| 1.2. Fshati Gjadër | Z. Gjergj Skandaj |
| 1.3. Fshati Zojs | Z. Paulin Ndreka |
| 1.4. Fshati Dragushë | Z. Viktor Lazri |
| 1.5. Fshati Kotërr | Z. Pepe Kola |
| 1.6. Fshati Mabë | Z. Nikoll Rrok Ndreka |

2. Brenda datës 28.02.2021 të mblidhen nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse vulat ekzistuese të çdo fshati për t'i nxjerrë jashtë përdorimit sipas rregullave në fuqi.

3. Të merren të gjitha masat nga Kryetari i Bashkisë për përgatitjen e vulave të reja dhe brenda muajit shkurt 2021 t'u dorëzohen vulat e reja Kryetarëve të Fshatrave të miratuar sipas pikës 1 të këtij vendimi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

4. Aparati i Bashkisë të marrë të gjitha masat për njoftimin e ish Kryetarëve të Fshatrave për dorëzimin e dokumentacionit të Kryetarët e Fshatrave të zgjedhur dhe të miratuar sipas pikës 1 të këtij vendimi, detyrë e cila duhet të përfundojë brenda dates 28.02.2021.
5. Kur ka raste të mosdorëzimit të dokumentacionit dhe vulës nga ish Kryetarët e Fshatrave brenda afatit të përcaktuar në pikat 2 dhe 4 të këtij vendimi, autorizohet Kryetari i Këshillit të Bashkisë për të bërë denoncimin në organet ligjore.
6. Shpërblimi mujor për Kryetarët e Fshatrave, të zgjedhur dhe miratuar sipas këtij vendimi, fillon në muajin shkurt 2021.
7. Ky vendim t'u bëhet i njohur nga Kryetari i Këshillit të Bashkisë, në rrugë zyrtare, të gjitha institucioneve shtetërore që trajtojnë probleme me pronat.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
ERNEST RAKAJ

